

VENDIM
Nr. 119, datë 13.3.2019

**PËR NJË SHITESË FONDI NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHTETIT,
MIRATUAR PËR VITIN 2019, DHE RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET
PROGRAMEVE TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 18, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në buxhetin e vitit 2019, në programin “Arsimi universitar”, në artikullin 604, i shtohet fondi prej 1 700 000 000 (një miliard e shtatëqind milionë) lekësh.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të përballohet duke pakësuar fondet, si më poshtë vijon:

a) 380 000 000 (treqind e tetëdhjetë milionë) lekë në shpenzimet korrente në programin “Arsimi bazë”, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

b) 300 000 000 (treqind milionë) lekë në shpenzimet korrente në artikullin 606, në programin “Përkujdesi social”, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) 1 020 000 000 (një miliard e njëzet milionë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama